

Çfarë është grupi integrues?

Në çdo zonë, por jo në të gjitha kopshtet funksionojnë grupe integrues. Në këta grupe rregjistrohen fëmijë të moshës parashkollore që kanë nevoja specifike mësimore ose ndonjë çrregullim fizik. Për rregjistrimin e fëmijës suaj në një grup të tillë kërkohet diagnozë me shkrim nga një qendër publike mjeko-pedagogjike. Këtë diagnozë duhet ta dorëzoni në kopsht në periudhën e rregjistrimeve. Nëse në lagjen që banoni nuk ka kopsht me grup integrues atëherë në bashkëpunim me mësuesin/en e kopshtit, Këshilltarin Shkollor dhe Këshilltarin e Edukimit Specifik, rregjistrimi i fëmijës bëhet në kopshtin më të afërt ku funksionon një grup integrues.

Grupet integrues ndiqen nga një numër i vogël fëmijësh, i cili për çdo grup përcaktohet nga bashkëpunimi i kopshtit me Këshilltarin Shkollor. Parametri bazë është serioziteti dhe shkalla e vështirësisë së rasteve që ndjekin kopshtin. Në disa kopshte grupet integruese funksionojnë të pavarura me një mësues/e të Edukimit Specifik dhe ndjekin orarin e grupeve klasike (8.00 – 12.15). Programi i tyre përshtatet nga mësuesi/ja i/e Edukimit Specifik sipas nevojave të fëmijëve që e ndjekin. Në të shumtën e rasteve, grupet integruese bashkëfunksionojnë me grupet klasike të kopshtit, nën bashkëpunimin e një mësuesi/eje të Edukimit të Përgjithshëm dhe të një mësuesi/eje të Edukimit Specifik. Programi hartohet nga të dy mësuesit/et duke marrë parasysh nevojat e çdo fëmije duke patur gjithmonë si qëllim integrimin gradual të të gjithë fëmijëve. Orari i grupit integrues dhe në këtë rast është në mëngjes (8.00 – 12.15).

Pse disa fëmijë nuk e fillojnë klasën e I-rë të fillores dhe ndjekin për së dyti programin e kopshtit parashkollor?

Fëmijë, të cilët për arsye serioze familjare si dhe për arsye shëndetsore nuk mund të ndjekin klasën e I-rë të fillores, mund të mbeten edhe për një vit në kopsht (përsëritje viti).

Përsëritja e vitit në kopsht bëhet gjithashtu kur vërtetohet nga shërbimi mjeko-pedagogjik apo Këshilltari i Arsimit Parashkollor, se fëmija paraqet vështirësi serioze për të ndjekur mësimet e klasës së I-rë fillore. Në çdo rast, kërkohet deklaratë personale nga të dy prindërit pse preferojnë përsëritjen e vitit.

A ekzistojnë kopshte parashkollorë për fëmijë me shumëlloj problemesh?

Po, ekzistojnë kopshte të Edukimit dhe të Arsimit Specifik të cilët ndjekin fëmijët pas propozimit të qendrës mjeko-pedagogjike ku bëhet diagnoza e invaliditetit ose e nevojës për arsimim specifik. Mënyrën e funksionimit të këtyre kopshteve e përcakton ligji për Edukimin dhe Arsimin Specifik të njerëzve invalidë ose me nevoja për arsimim specifik (Ligji 3699/2008 – Gazeta Zyrtare 199 -A- 2-10-2008).

Arsimi publik parashkollor në Greqi



Arsimi i detyruar i fëmijëve në Greqi fillon nga arsimi parashkollor (kopshti) dhe përfundon me mbarimin e gjimnazit. Kopshti parashkollor dhe shkolla fillore (6 vjet) u përkasin arsimit fillor. Gjimnazi i përket arsimit të mesëm dhe të gjithë këta varen nga Ministria e Arsimit, të të Mësuarit Gjatë Jetës dhe e Fesë.

Ndjekja e kopshtit publik është falas për të gjithë fëmijët.

Sa zgjat viti shkollor?

Kopshtet parashkollore hapen më 1 shtator dhe mbyllen për pushimet verore më 21 qershor të vitit tjetër. Ndërsa fëmijët fillojnë më 11 shtator dhe mbarojnë më 15 qershor.

Gjatë vitit shkollor kopshtet funksionojnë rregullisht nga e hëna deri të premten.

Në cilat ditë nuk funksionon kopshti?

Kopshtet nuk funksionojnë:

- Të shtunën dhe të dielën
- 28 Tetor (festë kombëtare).
- 30 Janar (festë fetare)
- E Hëna e Pastër (festë lëvizëse-në fillim të marsit)
- 25 Mars (festë kombëtare).
- 1 Maj (Festa e Luleve dhe grevë zyrtare për të gjithë të punësuarit)
- Festën e Shën Pnevma (festë fetare lëvizëse në fillim të qershorit)

Gjithashtu në periudhat e pushimeve:

- të Krishtlindjeve, 15 ditë, nga 24 dhjetori deri më 7 janar (festë fetare)
- të Pashkës, 15 ditë, (festë fetare lëvizëse, në pranverë, datat janë të ndryshme çdo vit).

Gjithashtu në festa lokale që nuk janë të njëjta për të gjithë vendin si:

- Dita e festës së Shenjtit të Qytetit (të shenjtit që mendohet mbrojtës i zonës) ku ndodhet kopshti.
- Dita e ndonjë feste lokale.

Gjithashtu duhet të përmendim se kopshti mund të qëndrojë i mbyllur edhe në data të tjera që nuk janë të njohura që në fillim të vitit, p.sh. kur bëhen seminarët e edukatorëve/mësuesve dhe kur bëhen mbledhjet e përgjithshme dhe zgjedhjet e shoqatës së mësuesve dhe të edukatorëve. Në këtë rast prindërit njoftohen në kohë.

Së fundi, kopshti funksionon me orar të reduktuar më:

- 27 tetor dhe më 24 mars, një ditë para festave të mëdha kombëtare: fëmijët marrin pjesë në festën që bëhet në shkollë dhe largohen sapo të mbarojë ajo.
- 17 Nëntor, përvjetori i kryengritjes së Politeknikut. Bëhen aktivitete për nder të luftës kundër diktaturës dhe për vendosjen e demokracisë.

Kur këto festa qëllon në fundjavë, të shtunën apo të dielën, këto aktivitete zhvillohen të premten.



Enti zbatues

POLIDHROMOS: Grupi dhe Botimi periodik për Dygjuhësinë dhe Shumëkulturën në Arsim dhe në Shoqëri



www.polydromo.gr
polydromo@polydromo.gr

Autore teksti

Koralia Agapitu, Athina Goci, Marianthi Kalafati, Fotini Kostudhi, mësuese të arsimit fillor.

Aleksandra Andhrusu, Pedagoge Asistente e Metodologjisë Didaktike, Departamenti i Arsimit dhe i Edukimit në Moshën Parashkollore.

Koordinatorë të programit

Birbili Maria – Cokalidhu Rula

Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe të Arsimit Parashkollor, Universiteti Aristoteli Selanik

Email: mmpirmpi@nured.auth.gr

tsokalid@nured.auth.gr

Website: www.polydromo.gr/dialogos

Përkthyes: **Valbona Hystuna** / Përpunuan tekstin: **Evi Marku**

Me mbështetjen e



Sa vjeç duhet të jetë fëmija im që të ndjekë kopshtin parashkollor?

- Kopshtin parashkollor mund ta ndjekin dy grupmosha fëmijësh:
- Moshë e parë (parashkollorë): fëmijë të cilët deri më 31 dhjetor të vitit të rregjistrimit mbushin moshën pesë (5) vjeç.
- Moshë e dytë (paraparashkollorë): fëmijë të cilët deri më 31 dhjetor të vitit të rregjistrimit mbushin moshën katër (4) vjeç.
- Në rregjistrim kanë prioritet fëmijët e moshës së parë. Në rast se, pas rregjistrimit të fëmijëve të moshës së parë, mbeten ende vende bosh, këta plotësohen nga fëmijët e moshës së dytë. Nëse kërkesat nga këta fëmijë janë të shumta bëhet short midis tyre, procedurë në të cilën përveç personelit didaktik marrin pjesë dhe dy përfaqësues nga prindërit.
- Kur ekzistojnë vende bosh, pa short rregjistrohen rastet e mëposhtme të fëmijëve të të dy moshave: a) fëmijët binjakë, përdërisa është zgjedhur njëri me short, b) fëmijët e prindërve me shumë fëmijë dhe c) fëmijët e edukatorëve/eve që japin mësim në atë kopësht dhe mësuesve të tjerë që punojnë në shkollat që ndodhen nën të njëjtën strehë (grup shkollash që përfshijnë një lagje të madhe).



Çerdhe apo kopshte parashkollorë?

Çerdhet varen nga Ministria e Shëndetsisë. Çerdhen e ndjekin fëmijët e moshave më të vogla nga ata që ndjekin kopshtin. Ndërkohë, në disa çerdhe ka edhe grupe parashkollorësh, por jo të gjitha. Të gjitha Bashkitë kanë çerdhe për banorët e tyre. Informacione përse i përket kur dhe si një fëmijë mund të rregjistrohet në një çerdhe të bashkisë mund t'i marrë gjithkush nga zyra e Politikës Sociale të Bashkisë në të cilën banon. Lajmërimet për rregjistrimet në çerdhe bëhen zakonisht në pranverë ose në fillim të verës. Mirë është që prindërit, fëmijët e të cilëve janë në moshën paraparashkollorë, (mosha e dytë) të bëjnë kërkesë edhe në çerdhet e Bashkisë, sepse në kopshtin publik kanë prioritet fëmijët e moshës së parë (5 vjeç) të cilët vitin e ardhshëm do të shkojnë në shkollë fillore.

Në ç'kopësht mund ta rregjistroj fëmijën tim? Çfarë nevojitet për këtë?

Çdo kopësht publik i përket një qarku të caktuar shkollor. Rregjistroni fëmijën tuaj në kopshtin e qarkut ku i përket adresa e shtëpisë suaj. Rregjistrime në kopësht bëhen nga 1 deri më 15 qershor të vitit të kaluar shkollor. Në rast se rregjistrimet janë të pakta dhe kanë mbetur ende vende bosh, mund të bëhen rregjistrime të parashkollorëve edhe pas këtyre datave. Kjo presupozon miratimin e Përgjegjësit të Zyrës Arsimore të zonës.

Për rregjistrimin në kopësht janë të nevojshëm këta dokumenta:

- Çertifikatë lindjeje nga Bashkia apo Komuna. Në rastin e të huajve, kjo çertifikatë duhet të jetë e përkthyer zyrtarisht në greqisht. Në rast se nuk ekziston çertifikatë, mjafton akti i lindjes nga gjendja civile greke (për fëmijët që kanë lindur në Greqi)
 - Libri i vaksinave ku të shihet kryerja e vaksinave të parashikuara
 - Analizat stomatologjike të fëmijës (dhëmbët)
 - Analizat okuliste të fëmijës (sytë)
 - Deklaratë personale e prindit ose e kujdestarit të fëmijës ku deklarohet adresa e shtëpisë së fëmijës.
- Sipas Ligjit 3386/2005, neni 72, për raste të veçanta, me mungesë dokumentash mund të rregjistrohen në kopshtet publike edhe fëmijë shtetas të vendeve të treta, përdërisa:
- Mbrohen nga shteti grek me cilësinë e refugjatit ose janë nën mbrojtjen e Komisionit të Lartë të Kombeve të Bashkuar.
 - Vijnë nga zona në të cilat mbizotëron gjendje e trazuar.
 - Kanë depozituar kërkesën për azil politik.
 - Janë shtetas të vendeve të treta që banojnë në Greqi (edhe pse nuk është sistemuar qëndrimi i ligjshëm në të).

Cili është orari i kopshtit?

Ekzistojnë dy tipe grupesh në kopshtet parashkollorë. Ai që funksionon në mëngjes dhe i dyti që është i plotë (ditor). **Sipas vendimeve** 1420/2007, T.B' orari i grupit të mëngjesit (grupi klasik i kopshtit) është:

Ardhja: 8.00 – 8.15

Largimi: 12.15 – 12.30

Dhe orari i grupit ditor (oloimero) është:

Ardhja: 8.00 – 8.15

Largimi: 15.45 – 16.00

Edhe grupet ditorë mundet që në disa raste të funksionojnë që shumë herët në mëngjes. Për funksionimin e këtij grupi nevojitet të paktën rregjistrimi i pesë fëmijëve të moshës së parë (parashkollorë). Orari i grupit ditor të mëngjesit është:

Ardhja: 7.00 – 7.15

Largimi: 15.45 – 16.00

Si në grupin klasik dhe tek ai ditor orari zbatohet rreptësisht. Prindërit që zgjedhin grupin ditor për fëmijët e tyre duhet të njohin cili është programi gjatë gjithë ditës. Për këtë arsye nuk lejohet largimi i fëmijëve më herët se 15.45' përveç rasteve kur ka arsye serioze dhe gjithmonë pas marrëveshjes me edukatorin/en. Ekzistojnë raste kur për arsye të mungesës së godinave disa grupe parashkollorë funksionojnë me **orar të përzier**. Kështu njëri grup ka **orar mëngjesi** (8.00 – 12.15) dhe tjetri ka **orar mbasdite** duke filluar nga ora 14.00-14.15 deri në orën 17.45 – 18.00. Ka mundësi që këta orarë të jenë të palëvizshëm gjatë gjithë vitit, por mund të jenë dhe të lëvizshëm, duke u ndërruar grupet çdo javë, nga fillimi deri në mbarimin e vitit shkollor.

Grupi klasik apo ditor?

Që të dy grupet ndjekin në përgjithësi të njëjtin program i cili përcaktohet nga vendimi ministror Φ. 32/190/81670/Γ1/20-7-2007, Gazeta zyrtare 1420/8.8.2007 fashikulli. B'. Në programin ditor të kopshteve të të dy tipeve ka kohë për aktivitete të organizuara me karakter tematik, kohë për aktivitete spontane të fëmijëve në ambientin e përshtatshëm të organizuar të kopshtit, gjithashtu kohë për ushqim dhe pushim.

Ndryshimi i grupit ditor të kopshtit është se mban fëmijët për një kohë më të gjatë të ditës (8 orë). Ka dy edukatorë/e që ndajnë orarin (njëra/i nga ora 8.00 deri më 12.00 dhe tjetra/i nga ora 11.45 deri më 16.00). Në programin e tij përfshihet dreka e fëmijëve si dhe pushimi i tyre. Orari i zgatur i grupit ditor të parashkollorëve, jep më shumë kohë dhe elasticitet mësuesit/es për zhvillimin e aktiviteteve edukative, por dhe më shumë shanse për zhvillimin e marrëdhënieve shoqërore dhe bashkëpunuese midis fëmijëve.

A ofron ushqim kopshti?

Jo, kopshti publik nuk u ofron ushqim fëmijëve që e ndjekin atë. Por, ky program përfshin orarin për ushqim, të cilin e sjellin fëmijët nga shtëpia. Për grupin klasik (të mëngjesit) është një kohë afërsisht midis 10.30 -11.00 për pasmëngjesin. Kështu fëmijët e këtij grupit duhet çdo ditë të sjellin me vete këtë vakt.

Për grupin ditor është në fuqi e njëjta orë për pasmëngjesin (10.30 -11.00). Në këtë grup parashikohet gjithashtu kohë e posaçme për drekën e fëmijëve (13.00-13.45). Nëse fëmija juaj është i rregjistruar në grupin ditor duhet që çdo ditë të sjellë me vete pasmëngjesin dhe drekën.

